



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 65, datë 25.04.2012

**PËR MARRJEN E MASAVE KORRIGJUESE NGA INSPEKTIMI MBI DËMET NË
SHOQËRINË E SIGURIMIT INTERSIG SH.A**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 13, 14, pika 23, dhe nenit 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Bazuar në programin e Inspektimit nr. 532 Prot., datë 17.10.2011, me objekt “Dëmet e paguara dhe të mbetura pezull për periudhën 01.07.2010 deri në 30.06.2011”, pranë shoqërisë së sigurimit “Intersig” sh.a, është kryer inspektimi tematik në vend. Nga ky inspektim është konstatuar se shoqëria e sigurimit nuk ka respektuar dispozita të caktuara të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” të ndryshuar, dhe të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Më konkretisht rezultoi se:

Praktika dëmsh të sigurimit të detyrueshëm motorik janë refuzuar pa shkaqe ligjore, në kundërshtim me nenin 12, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” si dhe ka mungesa në dokumentacionin e dosjeve të dëmeve, referuar kërkesave të neneve 9 dhe 11 të Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009, “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Shoqëria “Intersig” sh.a, ka vlerësuar disa praktika dëmsh në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi.

Shoqëria “Intersig” sh.a, është vënë në dijeni të shkeljeve të konstatuara nga raporti përfundimtar i inspektimit.

Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nenin 124, paragrafi 1, germa ë), të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, të urdhërohet shoqëria e sigurimit “Intersig” sh.a, të eliminojë shkeljet e evidentuara për periudhën e inspektimit, si më poshtë:
 - Të rishikojë praktikatat e kërkesave për dëmshtëpërblim të vlerësuarat në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi, duke kompensuar palën e dëmtuar me masën e dëmshtëpërblimit si dhe të depozitojë në Autoritet dokumentat që vërtetojnë pagesën e këtyre praktikave.
2. Bazuar në nenin 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, dhe nenin 125, paragrafi 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, shoqëria të paraqesë në Autoritet, brenda datës 31.05.2012, një raport të detajuar për masat e marra për eliminimin e këtyre shkeljeve.
3. Shoqëria e sigurimit të marrë masa për mospërsëritjen e shkeljeve të dispozitave të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 dhe Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm”, të konstatuara nga inspektimi.
4. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI